



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

25	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	21.02.2020, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lart për Punë Profesionale
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Derati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Ibrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Denë Qeta, Osmon Sadikaj, Hysni Maxharri, Drin Sadikaj, Lulzim Shoshi, Jashar Blakaj, Enver Rugova, zekie Sutaj, Ardon Arifaj, Jeta Balaj-Imeraj Hysen Pelaj.
Rendi i ditës: 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP."Ambienti" për vitin 2019. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblastë. 4. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha, 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së NLP "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2019. 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimi - Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me negocim, 7. Njoftimi rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020 .	
Diskutimet:	
Kryesuesi z. Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Kryesuesi - hedh në miratim kush rendin e ditës Miratohet një zëri.	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri rendi i ditës, me këto ndryshime të lartcekura.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

Kryesuesi – a ka dikush tjetër diçka.

Pasi që diskutime nuk pat hedh në miratim.

Vendimet:

Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.

Personat përgjegjës për zbatim:

Afati për zbatim:

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së NP."Ambienti" për vitin 2019, raportin e keni pasur me material dhe keni pasur mundësi ta analizoni.

Enver Rugova -- përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton raportin vjetor të punës së NP."Ambienti" për vitin 2019.

Haki Podrimaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete është blerë një kamion ka funksionuar vetëm tre muaj, çka ka ndodhur me të.

GIZI 2, 700 kontejner 146 mijë euro me ata mjete është planifikuar të blihet një kamionë dhe kompania të merr shtrirjen edhe në zonat tjera urbane, pasi që në zonën verore ka flukës të madh të qytetarëve, dhe duhet që kompania të ketë angazhime me të mëdha në pastrimin e rrugëve dhe trotuareve.

Enver Rugova – në bashkëpunimin me GIZI-in është dashur të blihen ky kamionë dhe defekti që i është bërë është shumë i kushtueshëm, aj kamionë ka punuar për një kohë shumë të shkurtër, duhet ta kemi edhe një kamionë.

Ajshe Metaj – përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyete këta kontejner ku janë vendosur.

Enver Rugova – 700 kontejner janë shpërndara në qytete në Istog.

Eliot Kukiqi – a keni planifikuar të zgjerohet rrjeti.

Enver Rugova – rrjeti është zgjeruar në mivada, punëtoret punojnë 24/7 pa festa.

Zenel Shatri – përshëndet të gjithë të pranishmit, jemi të kënaqur me punën e kompanisë por ka vend edhe për me mirë, të zgjerohet rrjeti, të zvogëlohen shpenzimet siç janë të cekura në raport.

Kryesuesi - Pasi që diskutime tjera nuk ka atëherë kalojmë në pikën tjetër.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja kalon: raportin vjetor të punës të NP."Ambienti" për vitin 2019, dhe të njëjtin ia kalohet KK-së për shqyrtim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 3.	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblastë. Fjalën ia kalon kryesueses së GGA-së Ajshe Metaj	
Ajshe Metaj - prezanton dhe sqaron, Strategjinë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblastë.	
Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka, hedhe në votim Strategjinë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblastë.	
Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,	
Diskutimet:	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Strategjinë për vitin 2019-2021 të Grupit të Grave Asamblastë, si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 4.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e katërt e rendit të ditës: Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba.	
Hysni Maxharraj – bënë prezantimin dhe sqarimin e Rishqyrtimit të Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba	
Kryesuesi pasi që diskutime nuk ka hedh ne votim, Në mënyrë unanime nga anëtarët e rekomandohet ti kalohet KK.	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba, dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së NLP "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2019, fjalën ja kalon z. Enver Rugova.	
Enver Rugova – prezanton dhe sqaron Raportin vjetor të punës së NLP "Stacioni i Autobusëve"	

për vitin 2019.

Ajshe Metaj – kësaj kompanie nuk po i shkojnë puna mirë, afati i bordit i ka skaduar, Inspektori u zgjodhe përmirësime ka shumë pak, ndërmarrja nuk i ka mundësit as pagat për ata punëtor aty që janë me i mbledhë.

Haki Podrimaj – problem po janë taksit ilegale, dhe çdo taksi duhet ta ketë edhe vend qëndrimin e jo të ndalen ku të munden. Ka probleme të shumëta në këtë çështje.

Kryesuesi – të hartohet një planë për daljen nga kjo gjendje.

Enver Rugova – është strategjia vetëm duhet ta zbatojnë.

Kryesuesi – kalojmë në pikën tjetër

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Raportin vjetor të punës së NLP “Stacioni i Autobusëve” për vitin 2019, dhe e njëjta i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e gjashtë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimi - Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me negociim,, fjalën ja kalon z. Jashar Blakaj.

Jashar Blakaj – prezanton dhe sqaron Propozimi - Vendimet e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me negociim.

Besa Ferati – përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete qfarë ndërtimi do të jetë ky, Rekomandon që për kuvend të jetë edhe projekt propozimet e detajuara.

Ardita Idrizaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete a janë të garantuara këto plane sipas projektit dhe a janë të garantuara që këto plane nuk do të ndryshohen.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedhe në votim

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: që Propozim Vendimi Nr.44/2020 dhe Propozim Vendimi Nr.45/2020 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me negociim, dhe të njëjtat ti kalohen KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7.

Diskutimet:	
Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e shtatë e rendit të ditës: Njoftimi rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020, fjalën ja kalon z. Enver Rugova. Enver Rugova – prezanton dhe sqaron, rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020. Zenel Shatri - janë dëmtuar edhe shenjat e komunikacionit në rrugë, të rregullohen. Kryesuesi pasi që diskutime tjera nuk ka rekomandohet që të shkoj në KK kjo pikë.	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Njoftimi rreth dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta që kanë ndodhur me datat 5-6.02.2020, dhe e njëjta i kalohet KK-së për shqyrtim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Diskutime tjera:	
Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.	
Mbledhja përfundoj :	12:13